



Periodiku AMF

I. Prezantimi i raportit vjetor të AMF-së për vitin 2007 në Kuvendin e Shqipërisë

Në kuadër të raportimit vjetor në Kuvendin e Shqipërisë, në datën 14 Prill 2008, Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Zj. Elisabeta Gjoni, raportoi përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat mbi aktivitetin e institucionit në vitin 2007.
Vijon në faqen 2

II. Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

II.1 Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar - mars 2008

Në periudhën janar - mars 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 1,473,845 mijë lekë, përkundrajt 1,286,775 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007.
Vijon në faqen 9

II.2 Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar - mars 2008

Duke e hedhur një vështrim të dhënave statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2008, të bie në sy që peshën më të madhe sipas llojit të transaksionit e zë "Shitje nga portofoli i ndërmjetësit" me 40.49 % dhe vendin e dytë "Blerje në tregun primar" me 36.10 %.
Vijon në faqen 11

III. Ngjarje dhe zhvillime të tjera

III.1 Organizohet seminari "Mbi sigurimet e jetës"

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me mbështetjen e Bankës Botërore, organizoi në Tiranë, në datat 23 dhe 24 prill 2008, në ambientet e hotel "Diplomat" seminarin 2-ditor "Mbi sigurimet e jetës".
Vijon në faqen 12

III.2 Organizohet misioni i TAIEX për sigurimet dhe risigurimet

Në datat 14-18 Mars, pranë ambienteve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, u organizua misioni i ekspertëve TAIEX me mbështetjen e Komisionit

European. Ky mision në thelb pati rishikimin e legjislacionit në fushën e sigurimeve.

Vijon në faqen 14

III.3 Pjesëmarrje në takimin 3-mujor të IOPS dhe në konferencën e katërt të kursimeve kontraktuale: "Çështje të mbikëqyrjes dhe rregullimit në pensionet private dhe sigurimin e jetës"

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS), në bashkëpunim me Bankën Botërore (WB) dhe Korporatën Ndërkombëtare të Financës (IFC) zhvilluan në Washington DC, SHBA gjatë periudhës 1-4 Prill 2008, takimet e mëposhtme:

- o Takimi i Komiteteve Teknikë dhe Ekzekutive të IOPS në datë 1 Prill 2008

Vijon në faqen 14

III.4 Pjesëmarrje në vizitën studimore në Bruksel për mbrojtjen konsumatore

Fondi i Hapur Rajonal për Reformën Ligjore, GTZ-ORF, në kuadër të komponentit për mbrojtjen e konsumatorit, organizoi në datat 13-17 Prill në Bruksel, Belgjikë vizitën studimore mbi forcimin e mbrojtjes së konsumatorit përmes vendosjes së një politike të qëndrueshme në vendet e Europës Juglindore.

Vijon në faqen 16

...*Vijon nga numri i kaluar*

IV. Standartet mbikëqyrëse për kërkesat e përshtatshmërisë dhe vlerësimi i shoqërive të sigurimit. (IAIS)

VI. Vlerësimi i kërkesave për përshtatshmëri

Koha e veprimit

31. Vlerësimi i aksionerëve kryesorë dhe të funksionareve kyç të një shoqërie sigurimi nga një mbikëqyrës, duhet së paku të ndodhë si pjesë e procedurës së licencimit, përpara se shoqërisë së sigurimeve t'i jepet e drejta e hyrjes në tregun e sigurimeve

Vijon në faqen 16

Në këtë numër:

Prezantimi i raportit vjetor të AMF-së për vitin 2007 në Kuvendin e Shqipërisë 2

Vështrim mbi tregun e Sigurimeve për periudhën janar - mars 2008 9

Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar - mars 2008 11

Organizohet seminari "Mbi sigurimet e jetës" 12

Organizohet misioni i TAIEX për sigurimet dhe risigurimet 14

Pjesëmarrje në takimin 3-mujor të IOPS dhe në konferencën e katërt të kursimeve kontraktuale: "Çështje të mbikëqyrjes dhe rregullimit në pensionet private dhe sigurimin e jetës" 14

Pjesëmarrje në vizitën studimore në Bruksel për mbrojtjen konsumatore 16

Standartet mbikëqyrëse për kërkesat e përshtatshmërisë dhe vlerësimi i shoqërive të sigurimit. (IAIS) 16

¹ Asistenca Teknikë dhe Shkëmbimi i Informacionit

Prezantimi i raportit vjetor të AMF-së për vitin 2007 në Kuvendin e Shqipërisë

Në kuadër të raportimit vjetor në Kuvendin e Shqipërisë, në datën 14 Prill 2008, Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Zj. Elisabeta Gjoni, raportoi përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat mbi aktivitetin e institucionit në vitin 2007. Me fjalën e saj, Zj. Gjoni bëri një përmbledhje të punës, përpjekjeve dhe arritjeve të AMF-së në drejtim të rregullimit dhe mbikëqyrjes të sektorit financiar jo-bankar në Shqipëri.

Në raportim u paraqit edhe ecuria e tregjeve financiare jo-bankare gjatë 2007, me fokus zhvillimet e veçanta që shoqëruan tregun e sigurimeve gjatë këtij viti. Raporti i plotë i veprimtarisë, i shoqëruar me dokumentin "Objektivat dhe programi afatmesëm i AMF-së" ishin në dispozicion të anëtarëve të Komisionit, të cilët vlerësuan pozitivisht punën e institucionit dhe bënë pyetje e komente të ndryshme në lidhje me zhvillimet në tregjet e mbikëqyrura dhe veprimtarinë e institucionit gjatë harkut kohor të një viti.

Me poshtë do të lexoni të plote fjalën e mbajtur nga Kryetarja e AMF-së

Të nderuar deputetë,

Është detyrim dhe privilegj i veçantë për mua të paraqitem sot këtu para Jush për të raportuar aktivitetin e kryer në vitin e parë të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Një datë e tillë nuk ka brenda vetëm simbolikën e vitit të parë, por edhe një vullnet të caktuar politik e institucional të shoqëruar me një

numër jo të vogël përpjekjesh dhe energjish profesionale e monetare të shpenzuara, për t'i dhënë jetë një projekti afatgjatë që ka për synim parësor ngritjen e nje infrastrukture të qëndrueshme të rregullimit dhe mbikëqyrjes të tregut tonë financiar.

Për vetë kompleksitetin e aktivitetit që mbulon, veprimtaria e AMF-së gjatë vitit 2007 ka qenë një gërshetim i elementëve të analizës dhe reagimit ndaj aktualitetit me hedhjen e bazave të një perspektive të shëndoshë të zhvillimit me përpjekjet për zhvillimin e sektorëve, pershtatjen e institucionit dhe forcave njerëzore për përballimin e objektivave. Kjo veprimtari ka qene sa bazike, aq edhe shkencore në drejtim të përfshirjes së standarteve.

Për këtë arsye, në këtë fjalë po adresoj shkurtimisht disa nga momentet dhe zhvillimet gjatë vitit 2007, ndërsa raporti që ju keni në dispozicion rendit në mënyrë të strukturuar ekspozenë e punës dhe arritjeve të AMF-se në vitin e parë të veprimtarisë së tij, të fokusuar në drejtimet kryesore:

- të aktivitetit ligjor të AMF-së, të rregullimit, të licencimit dhe të mbikëqyrjes;
- të ngritjes së kapaciteteve institucionale;
- të zhvillimit të tregjeve financiare jo-bankare
- të objektivave e projekteve për përballimin me sukses të sfidave të zhvillimit.

Të nderuar deputetë,

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare filloi veprimtarinë e tij në Tetor të vitit 2006, duke integruar funksionet e kryera nga rregullatorët e mëparshëm në fushat e sigurimeve, letrave

me vlerë dhe pensione private suplementare. Veprimtaria e AMF-së drejtohet nga një mision qartësisht i përcaktuar: **Garantimi dhe mbrojtja e interesave të investitorëve, të siguruarve dhe publikut në tërësi.**

Në fokusin e vitit 2007 u përcaktuan si prioritete:

(i) Mbikëqyrja e hollësishtme e tregut, me fokus atë të sigurimeve, për të garantuar në çdo kohë qëndrueshmërinë financiare të lojtarëve të tregut dhe aftësinë e tyre për të përmbushur në kohë detyrimet.

(ii) Hartimi i një programi afatmesëm 3-vjeçar të zhvillimit të mbikëqyrjes me elemente risku dhe të veprimtarisë së AMF-së në përgjithësi. (materiali i është bashkëngjitur raportit)

(iii) Rishikimi i të gjithë kuadrit ligjor ekzistues për tregjet financiare jo-bankare dhe përshtatja e tij me direktivat Europiane e standardet ndërkombëtare.

(iv) Zhvillimi i një sistemi të përshtatshëm të teknologjisë së informacionit me baza të dhënash të shumëfishta.

Për nga rritja, zhvillimet dhe ngjarjet e vecanta, viti 2007 mund të quhet edhe si **viti i sigurimeve në Shqipëri**, shprehur kjo në faktet e mëposhtme:

- Kapitali minimal i shprehur me kërkesën për rritjen e fondit të garancisë të shoqërive të sigurimit u përshtat sipas direktivave Europiane në nivelin 370 milionë lekë nga 100 milionë lekë të kërkuar më parë. Rritja e fondit të garancisë e vendos biznesin e sigurimeve në baza më të shëndosha e të sigurta.

- Për herë të parë në vitin 2007 u shfaqën hyrje substanciale të investimeve të huaja serioze në tregun Shqiptar të sigurimeve. Në vitin 2007 në

Shqipëri investuan, në Prill Aspis Group, në Korrik Uniqa dhe në Gusht TBIH i zotëruar në masë dërrmuese nga Vienna Insurance Group.

- Primet e sigurimeve u rritën me rreth 30% në krahasim me 2006. Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme në vitin 2007 arritën rreth 43 % më shumë se në 2006.

- Totali i aktiveve të tregut të sigurimit ka shënuar një rritje vjetore prej 16.47% në krahasim me vitin e kaluar, me një strukturë të orientuar kryesisht në investime në depozita bankare në masën 45% të totalit të aktiveve, pra me aktive likuide.

- Aftësia paguese e tregut u rrit me rreth 35% ndaj vitit të kaluar.

- Procesi i mbikëqyrjes u pasurua me përfshirjen e elementëve të analizës financiare me bazë risku, siç është sistemi IRIS.

- U shfaq forma e re e organizimit strukturor në formë grupi, çfarë kërkoi edhe përshtatje në sistemin e rregullimit dhe mbikëqyrjes.

Zhvillimet në tregun e sigurimeve nuk janë të rastësishme: qëndrueshmëria makroekonomike, zhvillimet e fundit të sektorit financiar, progresi në regjimin e rregullimit dhe mbikëqyrjes të gërshetuara me potencialet e mëdha që ofron vendi, janë faktorë që kanë ndikuar në rritjen e interesit të investitorëve. Investitorë prestigjizë janë në proces negociatash e vlerësimi për shoqëri të tjera, ndërkohë që vëmendje e madhe po i kushtohet nga tregjet ndërkombëtare privatizimit të plotë të INSIG-ut.

Duke patur parasysh peshën në sektorin financiar jo-bankar dhe zhvillimet e veçanta të tregut të sigurimeve, një pjesë e madhe e energjive dhe përpjekjeve të AMF-së u fokusuan në rregullimin dhe mbikëqyrjen e këtij tregu.



Sektori i sigurimeve në Shqipëri është relativisht i ri, me një histori rreth 8 vjeçare të një tregu të liberalizuar. Orientimi drejt një produkti të vetëm që është sigurimi i detyrueshëm motorrik, ka bërë që sektori të mbetet ende larg potencialeve që ofron vendi në fusha të ndryshme për zhvillimin e sigurimeve. Probleme të tjera të këtij sektori kanë të bëjnë më nivelin e qeverisjes shpeshherë larg parametrave të qeverisjes së shoqërive financiare, nivelin e administrimit të riskut apo konkurrencën e padrejtë në sigurimet e detyrueshme motorrike.

Në këto kushte AMF-së i është dashur të përkushtojë përpjekje e forca të konsiderueshme për të garantuar zbatimin e parimit bazë të një aktiviteti financiar: Shoqëritë financiare administrojnë para të konsumatorëve, qofshin këta të siguruar, aderues apo investitorë dhe si të tilla u nënshtrohen rregullave të caktuara që mbrojnë interesin e konsumatorëve. Në funksion të këtij parimi janë ndërmarrë një sërë masash korrektive si edhe sanksione brenda hapësirave ligjore në fuqi. Në të njëjtën kohë, është e domosdoshme dhe po punohet për përmirësime ligjore rregullative në këtë drejtim.

AMF ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme përgjegjësitë e marra nga shoqëritë e sigurimit dhe ka verifikuar nëpërmjet parametrave teknikë e financiarë burimet e mjaftueshme dhe formën për përballimin e këtyre përgjegjësisive. Sistemi periodik i raportimit dhe analizës i shoqëruar me verifikimet në vend nëpërmjet inspektimeve, kanë siguruar baza të dhënash për matjen e përgjegjësisive të marra nga ana e shoqërive.

Gjatë vitit 2007, AMF ka përfshirë në sistemin e tij të analizës metoda të mbikëqyrjes me bazë risku, të implementuara për herë të parë në fund të vitit 2006, siç është sistemi IRIS i përshtatur për shoqëritë e sigurimit të jo-jetës

në Shqipëri. Këta tregues financiarë, përfshijnë elemente të paralajmërimeve të hershme “early warnings”, në lidhje me situata të papërshtatshme me të cilat mund të përballen shoqëritë e sigurimit. Evidentimi në kohë i problemeve bën të mundur gjetjen e mënyrave për korrektimin, apo shmangien e këtyre situatave dhe shërben si mjet efikas për mbrojtjen e interesave të klientëve dhe publikut në tërësi.

Fenomen shqetësues mbetet niveli ende ulët i pagesave të dëmeve, çfarë pasqyrohet edhe në raportin e ulët dëme / prime prej rreth 21%, ndërkohë që raporti i shpenzimeve të tjera vijon të mbetet i lartë (57%). Gjatë vitit 2007, AMF ka ndërmarrë një sërë masash që pritet të sjellin efektet e tyre në përmirësimin e cilësisë së trajtimit të dëmeve dhe efektivisht në rritjen e këtij raporti. Janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi dokumenta për trajtimin e dëmeve: përkatësisht një udhëzim metodik bazuar në standartet e OECD-së, një udhëzim i Ministrit të Financave për vlerësimin e dëmeve në sigurimet e detyrueshme motorrike dhe një VKM për licencimin e vlerësuesve të pavarur të dëmeve në sigurime.

Gjithashtu, vëmendje e veçantë i kushtohet trajtimit të ankesave të klientëve e konsumatorëve. Ankesat duhet të regjistrohen nga shoqëritë e sigurimit në baza të veçanta të dhënash, të cilat monitorohen vazhdimisht nga AMF.

Megjithë hapësirat e pamjaftueshme ligjore në drejtim të Mbrojtjes Konsumatore, AMF ka vepruar në marrjen e masave të mëposhtme:

- Ka vënë në dispozicion të konsumatorëve një seksion të veçantë të mbrojtjes së konsumatorit në faqen e internetit dhe adresa aktive telefoni, e-maili, ku mund të dërgohen ankesat, sugjerimet apo komentet që lidhen me shërbimet dhe mbajtjen e premtimeve nga ana

e operatorëve.

- Në funksion të përdoruesve të mjeteve motorrike, AMF ka vënë në dispozicion në faqen e internetit një motorr kërkimi që evidenton korrektësinë e policave të sigurimit të detyrueshëm motorik.
- Në AMF është ngritur një njësi e veçantë për trajtimin e ankesave.

AMF po ndërmerr aktivitete për të përmirësuar proceset e mbikëqyrjes dhe për të thelluar përjasjen me bazë rrisht për tregun e sigurimeve në Shqipëri. Kalimi nga metoda tradicionale në këtë përjasje të re do të mbështetet nga një platformë elektronike e raportimit dhe analizës. Në bashkëpunim me BERZH-in ka nisur projekti për realizimin e platformës që pritet të fillojë funksionimin brenda vitit 2008. Ajo do të garantojë komunikime të shpejta e të besueshme me operatorët, kapacitete shumë të larta të analizës, përfshirë këtu edhe paralajmërimet e hershme. Platforma të ngjashme sot funksionojnë në vendet më të zhvilluara të Europës.

Sigurimet e detyrueshme motorrike patën vëmendjen e veçantë të AMF-së në 2007, duke qenë që ato ende mbajtën një peshë mbi 65% në strukturën e tregut të sigurimeve. Fenomeni i shitjes nën primet e miratuara me impakt në përkeqësimin e fitimeve, vazhdoi të përbëje një plagë të tregut Shqiptar të sigurimeve. Kompleksi i masave të përbashkëta, deri në politika të liberalizimit, duhet të shoqërohet me një sjellje të re të konkurrencës nga shoqëritë e sigurimit. Trajtimi i problemeve të tregut të sigurimeve të detyrueshme përfshiu (i) vlerësimin e gjendjes financiare të operatorëve dhe veçanërisht nivelin e provigjoneve teknike, (ii) inspektimet e vazhdueshme në vend mbi procesin e shitjeve dhe dëmshpërblimet, (iii) takimet e shpeshta

me drejtuesit e shoqërive (iv) krijimin e Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik sipas kërkesave të direktivave Europiane, (v) plotësimin e kuadrit ligjor për dëmet, investimin e provigjoneve, veprimtarinë e ndërmjetësve, etj.

Regjistri Online i Sigurimeve të Detyrueshme Motorrike, përbën një platformë raportimi dhe identifikimi në kohë reale të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorrik në formën e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, Kartonit Jeshil dhe Sigurimit Kufitar në përdorim nga data 1 dhjetor 2007.

AMF ka përfunduar tashmë hartimin e një projektligji të ri për sigurimet e detyrueshme, që synon përmirësimin e infrastrukturës në përgjithësi dhe liberalizimin gradual të çmimeve, të mbështetur nga forcimi i kontrollit financiar të operatorëve.

Të nderuar deputetë,

Ngritja e AMF-së një vit më parë, ka qenë një sinjal i qartë i konsolidimit dhe standartizimit të kuadrit rregullator të tregut financiar. Rregullimi i tregjeve financiare jo-bankare bazohet në 5 ligje kryesore dhe në një numër të madh aktesh nëligjore.

Rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit rregullativ i sektorëve të mbikëqyrur, ka qenë prioritet i punës së AMF-së për vitin 2007. AMF ka vlerësuar si element shumë të rëndësishëm, përjasjen me direktivat Europiane, në kuadër të angazhimeve të vendit për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Europian dhe përshtatjen e rregullave me kërkesat dhe nevojat e zhvillimit të shëndoshë të tregjeve. Gjithashtu, në vazhdim të procesit të integritit të tre rregullatorëve financiarë jo-bankarë është e domosdoshme vendosja e standarteve të njëjta të kuadrit rregullativ, për të shuar diferencat e



mëdha rregullative-mbikëqyrese midis të tre sektoreve. Kemi prekur me dorë në një vit pune të përbashkët përmasat e një sfide jo të vogël. Në këtë këndvështrim është punuar për të ngritur :

- Grup rregulla të licencimit në të tre sektorët mbi parime të njëjta të kërkesave për kapital, të kërkesave për themeluesit e organet drejtuese të shoqërive, (të ashtuquajtura “fit & proper”) karakteristike për aktivitetet financiare si dhe të qeverisjes së shoqërive që kryejnë këto lloj aktivitetesh.
- Grup rregulla të mbikëqyrjes bazuar në parimin e analizës së riskut, të masave parandaluese, si dhe të sanksioneve.

Në hartimin e akteve nënligjore janë shqyrtuar praktika të mira të vendeve të rajonit dhe janë implementuar standarde të vendosura nga shoqatat ndërkombëtare të rregullatorëve.

Ndërhyrja më e ndjeshme në kuadrin ligjor të sigurimeve, ishte amendimi i nenit 98 të ligjit bazë të fushës mbi rritjen e fondit të garancisë në nivelet e përcaktuara nga direktivat europiane, 370 milionë lekë, proces i cili është drejt përfundimit.

Gjatë vitit 2007 u rishikuan e miratuan nga Bordi i AMF-së të gjitha rregulloret ekzistuese dhe u hartuan e miratuan rreth 13 akte të tjera nënligjore. Aktualisht janë në proces hartimi 2 projekt ligje të reja dhe në proces rishikimi 2 ligje ekzistuese.

Gjatë 2007 u hartuan e miratuan akte nënligjore të lidhura me (i) investimin e provigjoneve teknike dhe matematike, (ii) praktikat e trajtimit dhe vlerësimit të dëmeve në sigurime, (iii) marrëveshjet e risigurimit, (iv) veprimtarinë e ndërmjetësve në sigurime. Këto vendime dhe rregullore, si edhe një sërë hapash rregullativë të ndërmarrë nga Bordi i AMF-së,

përbëjnë hapa cilësorë në rritjen e standardeve të rregullimit të tregut të sigurimeve.

Në 2007, AMF bashkëpunoi ngushtë me institucione të tjera në vend për shtrirjen e veprimtarisë siguroese në sektorët e ndërtimit, karburanteve, minierave dhe hotelierisë. Ky bashkëpunim mbështeti iniciativën e Qeverisë e të Kryeministrit për nxitjen e produkteve të sigurimeve që mbrojnë në masë të konsiderueshme interesat e publikut dhe të punësuarve nga rreziqet që mbart ushtrimi i aktiviteteve në sektorët e sipërpërmendur. Promovimi brenda vitit 2008 i këtyre produkteve, do të sjellë njëkohësisht edhe përmirësimin e strukturës së tregut të sigurimeve. Në realizimin e këtyre projekteve të rëndësishme do të vlerësonim shumë edhe vëmendjen dhe mbështetjen tuaj.

Në 2007, AMF mbajti një dialog sistematik me tregun e sigurimeve nëpërmjet diskutimeve, konsultimeve paraprake, trainimeve dhe formave të shpejta të komunikimit. Në faqen e internetit të AMF-së shoqëritë e sigurimeve gjejnë informacione konfidenciale të aksesueshme vetëm prej tyre, ndërsa në faqen e përbashkët mund të ballafaqojnë ecurinë e sigurimeve të detyrueshme mbi baza ditore.

Në fund të vitit 2008, shoqërive të shërbimeve financiare do t'u duhet të raportojnë pasqyrat e tyre financiare sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar. Duke e parë këtë si një sfidë të madhe për sektorin e sigurimeve, AMF ka ndërmarrë nisma të trainimit me pjesëmarrjen e lektorëve ndërkombëtarë me përvojë.

Hartimi i programeve të mbrojtjes nga katastrofat mbetet një sfidë madhore për tregjet financiare në Shqipëri. AMF ka paraqitur vlerësimet e saj mbi skema kombëtare, apo rajonale të mbrojtjes financiare nga katastrofat natyrore.

Megjithë peshën e madhe që ka zenë rregullimi dhe mbikëqyrja e sektorit të sigurimeve, gjatë vitit 2007 AMF ka vlerësuar rëndësinë e zhvillimit të sektorëve të pensioneve dhe letrave me vlerë në Shqipëri si faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e tregjeve financiare në vend.

Në sektorin e pensioneve, AMF po punon për hartimin e një projektligji të ri të pensioneve private vullnetare, që do të nxisë më tej zhvillimin e këtij sektori mbi baza të forta të garantimit dhe mbrojtjes së interesave të kontribuesve vullnetarë. Për mbikëqyrjen e tri fondeve ekzistuese, AMF ka hartuar dhe miratuar rregulla të raportimit e monitorimit.

Rregullimi i aktivitetit të pensioneve është i një rëndësie të veçantë, nisur nga kohëzgjatja e përgjegjësive të marra dhe niveli i lartë i ekspertizës që nevojitet për të menaxhuar këtë aktivitet. Referuar praktikave ndërkombëtare, janë të domosdoshme rregulla të qarta që përfshijnë profilin e mirëfilltë financiar të zotëruesve dhe më tej drejtuesve të këtyre operatorëve. Për sa më sipër dhe bazuar në rekomandimet e veçanta të FMN-së, angazhimet zyrtare për krijimin dhe zhvillimin e një sektori të shëndetshëm, AMF po ndjek një politikë kufizuese ndaj kërkesave për licencime, apo ndryshimeve në paketat kontrolluese në aktivitetin e pensioneve private suplementare në Shqipëri. Kjo politikë shihet si domosdoshmëri deri në miratimin e ligjit të ri sipas modeleve të suksesshme.

Hartimi i projektligjit të ri për pensionet private suplementare, përbën një nga prioritetet e AMF-së për vitin 2008. Puna ka nisur në 2007 me shqyrtimin e përvojave të ndryshme të rajonit dhe marrjes së ekspertizës nga Banka Botërore. Ligji i ri do të krijojë hapësirat për zgjerimin e tregut në përmbushje edhe të angazhimeve të Qeverisë Shqiptare ndaj FMN-së, për ngritjen e një sektori cilësor e

aktiv të pensioneve private suplementare në Shqipëri.

AMF mbetet pjesë aktive e studimeve dhe vlerësimeve të iniciuara nga Qeveria, me qëllim reformimin e sigurimeve shoqërore dhe pensioneve.

Tregu i letrave me vlerë sot kufizohet vetëm në letrat me vlerë të Qeverisë. Gjatë 2007, AMF ndikoi në zgjerimin e tregut dytësor dhe funksionimin e regjistrave përkatës, nëpërmjet licencimit dhe amendimeve rregullatore në kuadrin e një bashkëpunimi të ngushtë me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave.

AMF instaloi në faqen e internetit një sistem rating (krahasimi) GSRM, ku çdo bankë përditëson në kohë reale transaksionet dhe kuotimet për bonot e thesarit dhe obligacionet.

Interesi që është shfaqur për tregun e kapitaleve, si dhe kushtet e sotme të zhvillimit të biznesit dhe të infrastruktures institucionale, favorizojnë aktivizimin e tij.

Plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e letrave me vlerë është gjithashtu në vëmendjen e AMF-së. Krahas ligjit të hartuar së fundmi nga Ministria e Financave dhe të aprovuar nga Kuvendi, AMF po punon për projektligjin e Obligacioneve të Korporatave dhe Bashkive, të mbështetur nga BERZH-i dhe hartimin e projekt-ligjit të ri mbi investimet kolektive. Këto projekte synojnë përafrimin me direktivat Europiane dhe nxitjen e aktivizimit të tregut.

Në kryerjen e funksioneve të veta, AMF ka vlerësuar si një nga çelësat e suksesit bashkëpunimin me të gjithë aktorët dhe institucionet në vend, si edhe bashkëpunimin ndërkombëtar në tërheqjen e praktikave më të mira.

Gjatë 2007, AMF forcoi bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, në funksion të ruajtjes dhe forcimit të stabilitetit financiar të vendit. Bashkëpunimi i ka shërbyer parandalimit të rreziqeve, rritjes së transparencës, si edhe unifikimit të standarteve në sektorin financiar. Mjaft të efektshme kanë qënë edhe inspektimet e përbashkëta që AMF ka kryer me Bankën e Shqipërisë për çështje ku bashkëpunimi ka qënë i nevojshëm. Përsosja e teknologjisë së informacionit në të dy institucionet, po mundëson një shkëmbim informacioni e komunikim më të plotë e sistematik.

AMF është anëtare e 3 shoqatave ndërkombëtare të rregullatorëve të sigurimeve (IAIS), letrave me vlerë (IOSCO) dhe pensioneve (IOPS) dhe ka marrëdhënie e bashkëpunim të ngushtë me një numër të madh rregullatorësh në botë. Vlen këtu të përmendet nxitja e bashkëpunimit me Autoritetin Austriak të Tregjeve Financiare, menjëherë pas investimeve Austriake në tregun Shqiptar të sigurimeve dhe pensioneve.

Në 2007, AMF rriti komunikimin me Autoritetin Bankar Qendror të Kosovës në drejtim të shkëmbimit të përvojave reciproke, të vendosjes së standardeve dhe të organizimit të trainimeve dypalëshe. Rëndësi të veçantë pati shkëmbimi i informacioneve konfidenciale dhe kryerja e inspektimeve të përbashkëta.

Një ndër synimet tona mbetet përgatitja e profesionistëve të tregjeve financiare, ku mund të përmend: vlerësuesit, aktuarët, ndërmjetësit, analistët, etj. Në vitin 2007, AMF së bashku me USAID-in certifikuan klasën e parë të aktuarëve profesionistë në Shqipëri. Gjatë vitit 2007, AMF hartoi dy projektvendime shumë të rëndësishme në lidhje me vlerësuesit e dëmeve dhe ndërmjetësit në sigurime, të cilat u miratuan nga Këshilli i Ministrave në fillim të vitit 2008.

Transparenca jonë ka synuar informimin mbi të gjitha zhvillimet e tregjeve financiare jo-bankare në Shqipëri e më gjerë, dhe ka shërbyer në të njëjtën kohë për edukimin dhe rritjen e interesit dhe besimit të konsumatorit për produktet financiare. AMF ka vënë në dispozicion të publikut faqen e plotë interaktive të internetit, publikime mujore të raporteve statistikore, periodikut dhe botime të tjera informative edukuese.

Prioritet me peshë, sidomos për vitin e parë, ishte ngritja dhe konsolidimi i kapaciteteve institucionale.

Modeli i integritit funksional u reflektua në strukturën organike të institucionit, që megjithëse ishte pjesë e strategjisë së krijimit, u bë e mundur të realizohet vetëm pas disa muajsh. Struktura e re siguron ndarjen e qartë të funksioneve, lehtëson unifikimin e standarteve dhe procedurave për gjithë sektorin financiar, si edhe mundëson sfidat e integritit.

AMF ka zhvilluar (me mbështetjen e FSVC-së) një strategji të burimeve njerëzore, me politika të fokusuara kryesisht në drejtim të përzgjedhjes së stafit të kualifikuar, të nxitjes dhe motivimit në punë, rritjes së kapaciteteve nëpërmjet mbështetjes për trainime e certifikime profesionale të niveleve ndërkombëtare. Rialokimi i forcave të brendshme të AMF-se, në përshtatje me prioritetet e aktivitetit, është një proces që vazhdon edhe në 2008.

Funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm, si një siguresë e institucionit, ndihmon për të evidentuar risqet dhe për të garantuar përputhshmërinë ligjore.

Buxheti vjetor 2007 i AMF-së bazohet në masën 82% në të ardhurat e veta. Nga pikëpamja e fondeve të perdorura gjatë këtij viti, 63% e

përbëjnë shpenzimet e funksionimit të institucionit dhe 37% investimet e kryera, apo në proces. Nje peshë të konsiderueshme në zërin e investimeve zënë investimet për përsosjen e teknologjisë së informacionit.

Gjatë këtij viti, bordi i kompozuar nga 7 anëtarë ka zhvilluar mbledhje të shpeshta për të përmbushur një sërë detyrimesh ligjore për ngritjen dhe funksionimin institucional të AMF-së, për zbatimin e shkrirjes dhe konsolidimit të tre rregullatorëve ekzistues. Njëkohësisht, bazuar në punën e vlefshme të stafit, si edhe këshillimet e Bankës Botërore, Bordi ka ndjekur me kujdes zhvillimet e tregut, duke ushtruar me përgjegjësi kompetencat për mbikëqyrjen e kujdesshme të tregut. Gjatë një viti janë marrë një sërë vendimesh të rëndësishme rregullatore dhe funksionale.

AMF funksionon ende në ambiente zyrash jo të përshtatshme, sidomos në kushtet e aplikimit të projekteve afatgjata të teknologjisë. VKM-së 901, datë 19.12.2007 “Për miratimin strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve, nëpunësve civilë, nëpunësve të kabineteve dhe punonjësve mbështetës në administratën e disa institucioneve të pavarura” shkakton rënien e tretë të pagave të nëpunësve kryesisht të nivelit drejtues të AMF-së. Ky vendim nuk ndihmon në ruajtjen e kapaciteteve aktuale dhe ngritjen e nivelit të ekspertizës në institucion.

Hapat e hedhura në vitin 2007 për vetë kompleksitetin e fushës, shtrihen në shumë drejtime dhe konturojnë qartë një të ardhme të qëndrueshme.

Duke shprehur vlerësimin e institucionit që unë drejtoj për mbështetjen Tuaj të vazhdueshme, ju falenderoj për vemendjen.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

I. Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar - mars 2008

Në periudhën janar - mars 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 1,473,845 mijë lekë, përkundrejt 1,286,775 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007. Tregu i sigurimeve shënoi një rritje në masën 14.54% nga viti i kaluar, ku 81.99% e kësaj rritje i takoi tregut të sigurimeve të Jo-Jetës, ndërsa 18.01% tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i përket rritjes së tregjeve në veçanti, u shënuar një rritje në masën 49.55% të sigurimeve të Jetës dhe 12.59% të sigurimeve të Jo-Jetës.

Në periudhën janar - mars 2008, volumi i primeve nga sigurimi i detyrueshëm u rrit në masën 7.05% (nga të cilat vlen të përmendet pesha që ka portofoli MTPL në këtë rritje: 91.16%), ndërsa volumi i primeve të sigurimit vullnetar të Jo-Jetës u rrit në masën 26.70%. Në këtë periudhë u lidhën 128,247 kontrata sigurimi përkundrejt 106,787 kontrata të lidhura në të njëjtën periudhë të vitit 2007. Numri i kontratave të sigurimit të Jo-Jetës kapi vlerën 116,421 nga 99,533 që i takoi në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Portofoli MTPL shënoi rritjen më të madhe të numrit të kontratave me 6,315 kontrata ose në masën 37.39%.

Vlen të përmendet rritja në masën 63.03% e numrit të kontratave të sigurimit të Jetës kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës kapi vlerën 11,826 nga të cilat sigurimi “Jetë Debitori” pati një rritje prej 1,664 kontrata (44.83%), duke shënuar dhe dinamiken më të

lartë në rritjen e kontratave të sigurimit të Jetës.


Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - mars 2008 ishte rreth 310,411 mijë lekë, ose 27.44% më pak se në janar - marsin e vitit 2007. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto u përket sigurimeve

motorrike me 260,584 mijë lekë, apo 84.29% të totalit. Kjo ulje në dëmet e paguara bruto ndihet në potofolin "Kartoni Jeshil" ku kemi një ulje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me rreth 60.26% dhe ulje të numrit të dëmeve të paguara me rreth 44.52% krahasuar me 3 mujorin e parë të vitit 2007.


Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhen janar - mars (2007–2008)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2007	2008
Periudha janar-mars		
A) Sigurim i Jetës	67,980	101,663
B) Sigurim i Jo-Jetës	1,218,794	1,372,182
Nga këto:		
a) Sigurimi i Detyrueshëm	875,590	937,343
b) Sigurimi Vullnetar	343,205	434,838
TOTAL	1,286,775	1,473,845

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhen janar - mars 2008 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit për periudhën janar - mars 2008 (Jo-Jeta)




II. Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar - mars 2008

Duke i hedhur një vështrim të dhënave statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar - mars 2008, të bie në sy që peshën më të madhe sipas llojit të transaksionit e zë "Shitje nga portofoli i ndërmjetësit" me 40.49% dhe vendin e dytë "Blerje në tregun primar" me 36.10%.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2008 u dominua në masën 96.2% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 3.8% nga instrumenta afatgjatë (obligacione).

Nisur nga pjesëmarrja (numër transaksioni) sipas llojit të investitorëve, individëve apo persona juridikë, shihet se në peshë specifike më të lartë janë investitorët individë me 98.8% të totalit të transaksioneve në këtë treg.

Letra me Vlerë të Qeverisë 2008 / Government securities 2008



Dy grupet e transaksioneve "B" dhe "C"

Transaksioni i llojit B "Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar" shënoi një ulje të lehtë prej 135.07 milionë lekë ose 4.22% krahasuar me një vit më parë dhe numri i transaksioneve të këtij lloji, po ashtu, shënoi një ulje prej 5.43% .

Transaksioni i llojit C "Blerje nga individët para afatit të maturimit" shënoi një ulje prej 35.69 milionë lekë ose 25.72% krahasuar me janar-marsin 2007 dhe numri i transaksioneve të këtij lloji, po ashtu, shënoi një ulje prej 20.63%.

Kjo ulje në vlerë absolute të totalit të transaksioneve të llojit "B" dhe "C" në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2007 kapi vlerën 170.77 milion lekë ose 5.12%.

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë 2007, 2008

Lloji i Transaksionit		Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi (në %)
		2007	2008	'08/'07-1
<i>Periudha janar - mars</i>				
Letra me Vlerë të Qeverisë				
B	Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	3,199.39	3,064.32	(4.22)
	<i>Individë</i>	3,146.31	2,733.15	-
	<i>Persona juridikë</i>	53.08	331.17	-
C	Blerje nga individët para afatit të maturimit	138.76	103.07	(25.72)
	<i>Individë</i>	97.26	100.45	-
	<i>Persona juridikë</i>	41.51	2.63	-

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

I. Organizohet seminari “Mbi sigurimet e jetës”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me mbështetjen e Bankës Botërore, organizoi në Tiranë, në datat 23 dhe 24 prill 2008, në ambientet e hotel “Diplomat” seminarin 2-ditor “Mbi sigurimet e jetës”.



Në fjalën përshëndetëse, Z. Keler Gjika, N/Kryetar i AMF-së, theksoi rëndësinë e seminarit në lidhje me sigurimet e jetës në Shqipëri. Më pas, Z. Gjika bëri prezantimin e lektorit kryesor të seminarit Z. Don Mc Isaac, ish drejtor i grupit të sigurimeve në Bankën Botërore dhe të Zj. Serap Gunelal, përfaqësuese e Bankës Botërore.

Zj. Serap Gunelal, falënderoi pjesëmarrësit në seminar, bëri prezantimin e temave të diskutimit e me pas i kaloi fjalën lektorit, Z. Don Mc Isaac, i cili drejtoi seminarin për dy ditët radhazi.

Temat e trajtuara në ditën e parë ishin:

o **Tipet e kontratave të sigurimit të jetës**, këtu u veçua fakti, që në tregun shqiptar të sigurimeve të jetës aplikohen më së shumti kontratat “Term”, me periudhë mesatarisht një vjeçare, ndërkohë që po bëhen përpjekje për hedhje në treg të kontratave “Term” me afat më të gjatë si dhe për kontratat “Endowment”

o **Taksat në kontratat e sigurimit të jetës**, u theksua fakti që shoqëria e sigurimit taksohet në fitim, ndërkohë që nuk ka taksa as në prime e as në përfitimin e shumës së sigurimit. Gjithashtu, në lidhje me këtë temë, u bënë krahasime edhe me vende të tjera të zhvilluara si UK dhe USA.

o **Taksat në skemat e pensioneve**, u diskutua nëse kontributet, të ardhurat nga investimet dhe përfitimi i pensionit janë të taksueshme.

o **Ndryshimet në sigurimin e jetës ndaj sigurimit të jo-jetës**, lidhet me faktin që këto kontrata janë kontrata kursimi për të ardhmen për periudha relativisht të gjata, kështu që tarifat e primeve dhe të provigjoneve matematike projektohen për këto periudha.

Në elementet e projektuar konsiderohen:

1. Vdekshmëria
2. Të ardhurat nga investimet
3. Ndërprerja e kontratës së sigurimit në mënyrë vullnetare prej policëmbajtësit
4. Shpenzimet administrative

Në seminar u trajtua në mënyrë të detajuar çdo tip kontrate të sigurimit të jetës, kontratat individuale të cilat janë: “Term”, “Endowment”, “Whole” “Life”, “Unit Linked”, “Universal Life”, etj.

U diskutuan primet e sigurimit, të cilat mund të jenë të pagueshme në mënyrë të menjëhershme apo me këste, periudha e sigurimit, grupimi i kontratave me përfitim në

vdekje apo në mbijetesë, mënyra e përfutimit të shumës së siguruar në formën e një shume të vetme apo në formë anuitetesh.

Për kontratat kolektive të sigurimit të jetës, u diskutuan:

o **Kontratat e sigurimit të jetës në grup**, kontrata e formës “Term” një vjeçare, e cila i ofrohet punëdhënësit për mbulimin me sigurim të punëmarrësve të tij.

o **Kontrata të një grupi kreditor**, sigurimi i ofrohet huadhënësit për sigurimin e jetës të një grupi njerëzish, të cilët kanë marrë hua.

o **Micro insurance**, këtu u paraqit eksperiencia e një shoqërie sigurimi në Afrikë e cila ofron mbulim për shpenzimet funerale.

o **Skemat e kursimit të jetës dhe planet e pensionit**, të cilat mund të ndërtohen me kontribut ose me përfitim të përcaktuar. Lidhur me këtë është diskutuar për të dyja fazat, si atë të akumulimit edhe atë të pagesës së përfitimit.

Temat e trajtuara në ditën e dytë ishin:

o **Roli i mbikëqyrësit në sigurime**. Autoriteti duhet të mbikëqyrë garancitë që i ofrohen pjesëmarrësve në skemat e pensioneve, duhet të vendosë rregulla lidhur me regjistrimin e planit të pensionit, me anëtarësimin, financimin, investimin e fondeve, rregullat lidhur me moshën e daljes në pension, si dhe format optimale lidhur me përfitimin e pensionit.

o **Mbajtja e llogarive në sigurimin e jetës**. Këtu u diskutuan:

1. **Të ardhurat nga primet, provigjonet matematike, tabelat e vdekshmërisë**, ku u diskutua lidhur me cilësinë e tyre,

krahasueshmërinë midis operatorëve të ndryshëm të tregut, mundësinë e përdorimit të tabelave të ofruara nga risiguruesit apo të vendeve të tjera, si dhe mundësinë e ndërtimit të tabelave të mortalitetit.

2. **Të ardhurat nga investimet**, u trajtua rëndësia e përshtatshmërisë së termave dhe të ardhurave nga asetet ndaj garancive të ofruara.

o **Investimet e provigjoneve matematike**, të cilat duhet të sigurojnë vlerën, të maksimizojnë të ardhurat prej investimit, të ruajnë normat e likuiditetit, të përshtatë asetet dhe detyrimet sipas yieldit si dhe termit të maturimit.

o **Vendodhja e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike**, në kontekstin e klasave të aseteve me rrezikshmeri më të lartë.

o **Mbikëqyrja në sigurime**, këtu u diskutua licencimi i shoqërive të sigurimit, lejimi për hedhjen në treg të produkteve të ndryshëm, licencimi i ndërmjetësve si dhe menaxhimi i ankesave të konsumatorit.

o **Mbikëqyrja e aftësisë paguese të shoqërive të sigurimit**, ku të rëndësishme ishin: kapitali i shoqërisë së sigurimit, raportet financiare, mbështetja në profesionalizmin e aktuarëve, financierëve, shoqatave profesionale dhe pajtueshmëria në sistemin e raportimit prej shoqërive të sigurimit.

Pjesë e rëndësishme në mbikëqyrjen e aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit të jetës, janë provigjonet matematike. Masa prudente duhen marrë si në yieldin e investimeve, ashtu edhe në parashikimet lidhur me tabelat e vdekshmërisë, sëmundshmërisë dhe ndërprerjes në mënyrë vullnetare të kontratës së sigurimit. Aktuari i shoqërisë duhet të japë raporte të hollësishme lidhur me hapat dhe hipotezat e ngritura lidhur me këto parashikime.

Në përfundim të temave të trajtuara, Z. Don Mc

Isaac zhvilloi disa case-study, konkluzionet e të cilave u diskutuan nga të gjithë pjesëmarrësit që ishin të pranishëm në seminar.

Seminari gjeti interes dhe u vlerësua nga përfaqësues të shoqërive të sigurimit, përfaqësues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare si dhe Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës (CBAK).

Në fund të seminarit pjesëmarrësve iu shpërndanë certifikata nga Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Zj. Elisabeta Gjoni.

II. Organizohet misioni i TAIEX për sigurimet dhe risigurimet

Në datat 14-18 Mars, pranë ambienteve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, u organizua misioni i ekspertëve TAIEX me mbështetjen e Komisionit Europian. Ky mision në thelb pati rishikimin e legjislacionit në fushën e sigurimeve. Cikli i prezantimeve u hap nga Kryetarja e AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, e cila bëri një paraqitje të situatës rregullative dhe strukturës së tregut të sigurimeve në Shqipëri.

Misioni në fjalë u përfaqësua nga dy ekspertë gjermanë me eksperiencë në fushën e sigurimeve, Z. Von Ameln dhe Z. Dossinger, të cilët fillimisht paraqitën një pamje të situatës rregullative në Gjermani dhe rregullatorit gjerman Bafin.

Në vijim, ekspertët prezantuan situatën ligjore të BE, implementimin e direktivave në kuadrin ligjor gjerman si dhe metodologjinë e re të Mbikëqyrjes me Bazë Risku, metodologji të

cilën Gjermania është duke e implementuar përpara afateve të përcaktuara nga BE. Fokus i veçantë iu kushtua kuadrit rregullativ të mbikëqyrjes së sigurimeve dhe menaxhimit të riskut nga kompanitë e sigurimit.

Në përfundim të misionit u diskutuan rekomandime, të cilat mund të aplikohen në ndryshimet e mundshme ligjore në fushën e sigurimeve në Shqipëri.

III. Pjesëmarrje në takimin 3-mujor të IOPS dhe konferencën e katërt të kursimeve kontraktuale: “Çështje të mbikëqyrjes dhe rregullimit në pensionet private dhe sigurimin e jetës”

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS), në bashkëpunim me Bankën Botërore (WB) dhe Korporatën Ndërkombëtare të Financës (IFC) zhvilluan në Washington DC, SHBA gjatë periudhës 1-4 Prill 2008, takimet e mëposhtme:

o Takimi i Komiteteve Teknike dhe Ekzekutive të IOPS në datë 1 Prill 2008,

o Konferenca e katërt e kursimeve kontraktuale: “Çështje të mbikëqyrjes dhe rregullimit në pensionet private dhe sigurimin e jetës”, 1-4 Prill 2008.

Takimi i radhës së IOPS pasoi takimin vjetor të mbajtur në Pekin, Kinë në muajin Nëntor 2007. Shumë projekte dhe studime të ndërmarra gjatë takimit vjetor u shqyrtuan për ecurinë

² Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit

dhe stadin e tyre të zhvillimit në takimin tremujor te radhës. Kështu në takimin e IOPS-it në Washington DC, u trajtuan tema të rëndësishme si:

- (i) Të reja rreth reformës në sistemin e pensioneve në Kore;
- (ii) Ndërveprimi midis skemave të garantuara dhe autoriteteve të mbikëqyrjes;
- (iii) Metodologjia e mbikëqyrjes on-site dhe off-site;
- (iv) Draft-instruksione për përdorimin e fuqisë ndërhyrëse, sanksioneve dhe detyrimeve;
- (v) Rezultate analitike të projektit të informacionit DC - Itali, Drejtimi i fondeve të pensioneve – Afrika e Jugut, Strukturat e mbikëqyrjes të pensioneve – Britania e Madhe;
- (vi) Projekti “cost and fees”;
- (vii) Informacion dhe diskutim për çështjet e anuities;
- (viii) Drejtimi i Autoriteteve Mbikëqyrëse;
- (ix) IOPS “Toolkit” për mbikëqyrjen mbi bazë risku;
- (x) Tabelat e vdekjes; etj.

Me shumë interes qenë trajtimi i disa eksperiencave, Australia – të gjithë fondet e pensioneve nga statistika tremujore rezultojnë me humbje, Italia – problemi i besimit, skemat DC po premtojnë masa përfitimesh gjithnjë e më të ulëta dhe skemat DB po përballen me pamundësi për të mbajtur premtimet, India – është aktualisht treg në zhvillim, janë aprovuar 3 fonde (te parat) ku aderojnë 4.5 milion njerëz, rëndësisë së mbikëqyrjes mbi bazë risku i mëshoi shumë përfaqësuesi i PBGC, SHBA, etj.

Ndërsa Konferenca e katërt e kursimeve kontraktuale: “Çështje të mbikëqyrjes dhe rregullimit në pensionet private dhe sigurimin e jetës”, pati si objektiv të bënte prezente rezultatet e punës së mbështetur nga Grupi i Bankës Botërore i ngritur për të ndihmuar vendet, për të zhvilluar sisteme efektive mbikëqyrjeje, për të lehtësuar reformën e sistemit të pensioneve si dhe për të adresuar

probleme që shqetësojnë zhvillimin e tregut të pensioneve. Konferenca paraqiti modele të zhvillimit të tregut dhe punës bashkëkohore akademike si dhe opsione praktike politike.

Ndër temat më të rëndësishme që u trajtuan në konferencë mund të veçojmë:

- (i) Mbikëqyrja mbi bazë risku në fondet e pensioneve, praktikat emergjente më të mira;
- (ii) Sfidat për të kaluar në mbikëqyrjen mbi bazë risku. A është zgjidhja e duhur për të gjithë vendet?
- (iii) Menaxhimi i riskut në fondet e pensioneve;
- (iv) Menaxhimi i riskut në planet DC
- (v) Organizimi i fazës së pagesës: Sfida dhe opsione politike;
- (vi) Projekti i Bankës Botërore për anuities: Një përmbledhje e gjetjeve dhe mësimave politike;
- (vii) Trajtimi i riskut të jetëgjatësisë;
- (viii) Kapitali i lëvruarve të annuities dhe Solvency II;
- (ix) Tendencat të përgjithshme në politikën e konkurrencës;
- (x) Opsione politike për rritjen e efikasitetit dhe zvogelimin e kostove;
- (xi) Portofolet optimale për fondet e pensioneve; etj.

Temat e paraqitura u trajtuan me shumë profesionalizëm dhe pati mjaft diskutime dhe pyetje rreth tyre. Gjatë seancave, delegacioni Shqiptar i kryesuar nga Kryetarja e AMF, Zj. Elisabeta Gjoni, realizoi takime me delegacione homologe në drejtim të shkëmbimit të eksperiencës, me drejtues të lartë të Bankës Botërore që mbulojnë Shqiperinë, si dhe me drejtues të fondacionit/donator “FIRST Initiative” ku AMF ka paraqitur një kërkesë për miratim projekti. Në fund të konferencës u shpërndanë certifikata të pjesëmarrjes për të gjithë të pranishmit.

IV. Pjesëmarrje në vizitën studimore në Bruksel për mbrojtjen konsumatore

Fondi i Hapur Rajonal për Reformën Ligjore, GTZ-ORF, në kuadër të komponentit për mbrojtjen e konsumatorit, organizoi në datat 13-17 Prill në Bruksel, Belgjikë vizitën studimore mbi forcimin e mbrojtjes së konsumatorit përmes vendosjes së një politike të qëndrueshme në vendet e Europës Juglindore.

Gjatë kësaj periudhe u bënë takimet e mëposhtme:

o Vizitë në Organizatën Europiane të konsumatoreve (BEUC). Kjo vizitë u shoqërua me një prezantim të shkurtër në lidhje me fushat më të rëndësishme të mbrojtjes konsumatore.

o Prezantime pranë ambienteve të Komisioneve, “D.G for health & Consumer protection”, “ D.G for Competition”, dhe “ D.G Enlargement”

Lektorët prezantuan Direktivat Europiane në lidhje me Mbrojtjen Konsumatore.

Disa nga Direktivat që u cituan ishin:

1. Direktivë 1993/13/EEC
2. Direktivë 1999/44/EC
3. Direktivë 97/7/EC
4. Direktivë 1990/314/EEC si dhe rekomandimet 98/257/EC & 2001/310/EC

o Takim pranë Misionit Shqiptar në Bruksel. Në këtë takim u bë një prezantim i shkurtër nga përfaqësuesi i grupit vizitor shqiptar (GTZ) në lidhje me projektin aktual që po zhvillohet me objekt: Mbrojtja Konsumatore. Secili nga pjesëtarët e grupit vizitor bëri një

prezantim të institucionit dhe rolit të tij në lidhje me Mbrojtjen Konsumatore.

o Gjithashtu, tepër e rëndësishme ishte dhe vizita në Parlamentin Europian, në të cilin u zhvillua një takim rreth 60 minuta me Zj. Doris Pack, e cila bëri një prezantim të marrëdhënieve me vendet e Europës Juglindore.

Vizita u cilësua shumë e vlefshme e do të pasohet nga të tjera në vazhdim.

...Vijon nga numri i kaluar

Standartet mbikëqyrëse për kërkesat e përshtatshmërisë dhe vlerësimi i shoqërive të sigurimit (IAIS)

VI. Vlerësimi i kërkesave për përshtatshmëri

Koha e veprimit

31. Vlerësimi i aksionerëve kryesorë dhe të funksionarëve kyç të një shoqërie sigurimi nga një mbikëqyrës, duhet së paku të ndodhë si pjesë e procedurës së licencimit, përpara se shoqërisë së sigurimeve t'i jepet e drejta e hyrjes në tregun e sigurimeve dhe nëse kjo shoqëri është e licencuar, atëherë vlerësimi duhet të ndodhë përpara se aksioneri kryesor t'i ketë blerë aksionet e tij ose përpara se funksionari kyç t'i ketë ushtruar detyrat e tij brenda shoqërisë së sigurimit.

Gjetja e fakteve

Detyrimi për të mbledhur të dhëna të mjaftueshme

32. Mbikëqyrësi duhet të mbledhë të dhëna të nevojshme dhe të mjaftueshme, në mënyrë që të vlerësohet nëse individi i përmbush kërkesat për përshtatshmëri. Paragrafët e mëposhtëm paraqesin disa mënyra se si mbikëqyrësit mund t'i mbledhin këto informacione por në praktikë ata mund të përdorin edhe metoda të tjera për të kryer këtë detyrë. Informacioni që duhet mbledhur dhe vlerësimi që duhet bërë, ndryshon në varësi të pozicionit të personit që po vlerësohet, në lidhje gjithashtu edhe me interesat që duhen mbrojtur.

Të dhënat që kërkohen nga individi

33. Në mënyrë që të mbledhë të dhëna për vlerësimin e individit, mbikëqyrësi duhet të kërkojë paraqitjen e:

o pyetësorit që duhet plotësuar dhe firmosur nga individi;

o një përmbledhje që tregon kualifikimet profesionale dhe historikun e punësimit;

o ndonjë tjetër informacion të nevojshëm që ndihmon në vlerësimin e individit.

Përmbajtja e pyetësorit

34. Pyetësi i përmendur në paragrafin e mësipërm duhet të përmbajë pyetje lidhur me:

o problemet financiare ose falimentimin individual;

o problemet financiare ose falimentimin e një institucioni ku individi ka qenë një aksioner kryesor apo një funksionar kyç;

o ndonjë përgjegjësi civile për mos shlyerje borxhesh;

o pezullimin, shkarkimin, përjashtimin nga pozicioni i drejtorit apo administratorit të një

kompanie apo organizate;

o masat korrigjuese ose parandaluese të imponuara te shoqëria, në të cilën individi ishte apo është një aksioner kryesor ose një funksionar kyç;

o dënimin për vepër penale të personit;

o dënimin për vepër penale të shoqërisë, në të cilën individi ishte apo është një aksioner kryesor ose një funksionar kyç;

o rezultatet e vlerësimeve të mëparshme mbi provën e përshtatshmërisë, ose sanksione apo masa disiplinore të marra nga një mbikëqyrës tjetër;

o ndonjë masë disiplinore e vendosur ndaj individit si anëtar i ndonjë shoqërie profesionale;

o çështje ligjore të pazgjidhura, ku individi në fjalë është personalisht subjekti i një kauze civile apo kriminale;

o ndonjë fakt apo rrethanë tjetër që individi e shikon si të rëndësishme për procesin e vlerësimit.

Pasojat për një plotësim të pasaktë të pyetësorit

35. Çdo përgjigje e pyetësorit që është e pavërtetë ose me karakter mashtrues dhe gjithashtu fshehja e informacioneve të rëndësishme, do të konsiderohet si një shenjë e fortë e mungesës së integritetit të individit. Individi duhet të paralajmërohet për këtë pasojë.

Informacione në lidhje me shoqërinë

36. Nëse aksioneri kryesor që po vlerësohet është një shoqëri, mbikëqyrësit duhet të

rishikojnë:

o saktësinë dhe fuqinë financiare (duke përfshirë edhe strukturën e kapitalit);

o natyrën dhe qëllimin e biznesit;

o aksionerët kryesore dhe funksionarët kyç;

o strukturën e shoqërisë dhe grafikën e organizimit.

Kontrolli për precedent penal dhe të dhëna policore

37. Mbikëqyrësi duhet t'i përdorë në mënyrë të arsyeshme të dhënat e autoriteteve policore dhe të zyrës financiare. Duhet të theksohet që faktet e vërtetuara gjatë këtij investigimi dhe procesi janë pothuajse me aq rëndësi sa edhe rezultati i një procesi gjyqësor.

Regjistra dhe baza të tjera të dhënash

38. Mbikëqyrësi duhet të kontrollojë edhe regjistra e baza të tjera të dhënash, si p.sh organizmat e regjistruar në dhomën e tregtisë, të kontrollojë për falimentimet si dhe publikimet për median.

Intervista

39. Nëse është e nevojshme, mbikëqyrësi mund të zhvillojë edhe një intervistë me individin.

Konsultimi me mbikëqyrësit e tjerë

40. Në rastet kur aksionerët kryesorë ose funksionarët kyç të shoqërisë së sigurimit njihen nga mbikëqyrës të tjerë (brenda ose jashtë të njëjtit juridiksion) ato duhet të komunikojnë me kolegët e tyre si pjesë përbërëse e procesit të vlerësimit.

Shoqëritë në një tjetër juridiksion

41. Nëse aksioneri kryesor që po vlerësohet është një shoqëri e cila vepron në një tjetër juridiksion, mbikëqyrësi duhet të marrë informacionet e duhura nga rregullatorët përkatës, nëse shoqëria në fjalë ka një reputacion të mirë në atë juridiksion.

Analizat dhe vendimmarrja

42. Në bazë të informacioneve të mbledhura, mbikëqyrësi duhet të vlerësojë nëse individi i përmbush kërkesat për përshtatshmëri. Nëse këto të dhëna ngrenë akoma dyshime për përmbushjen e këtyre kërkesave nga individi, atëherë mbikëqyrësi duhet të bëjë kërkime të mëtejshme derisa të jetë në gjendje të marrë një vendim. Vlerësimi duhet të kryhet brenda një periudhe të caktuar kohe.

Paragjykimet në vlerësim

43. Është e njohur se vlerësimi për përshtatshmërinë mund të jetë një çështje paragjykimi dhe që mbikëqyrësi mund të ketë të dhëna të tjera shtesë që i përdor në mënyrë të ndryshme nga njëra çështje te tjetra. Megjithatë, çdo vendim negativ duhet të justifikohet dhe do të shqyrtohet në mënyrë të pavarur nga një person i dytë. Mbikëqyrësit duhet të kenë parasysh që edhe pse dënimet për vepra penale dhe sjellja e gabuar mund të jenë faktorë të rëndësishëm në vlerësimin e përshtatshmërisë të një individi, ata duhet të marrin parasysh edhe kohën që ka kaluar që nga sjellja apo dënimi, sa të rënda kanë qenë veprimet e tij dhe gjithashtu sjellja e mëpasshme e këtij individi.

Vlerësimi lidhur me një pozicion të caktuar

44. Një person që konsiderohet si i përshtatshëm për një pozicion të caktuar, mund të mos konsiderohet si i tillë për një pozicion tjetër me detyra të ndryshme, ose mund të konsiderohet si i papërshtatshëm për

të njëjtin pozicion në një institucion tjetër dhe anasjelltas, një individ që konsiderohet si i papërshtatshëm për një pozicion të caktuar, në një institucion të caktuar, në rrethana të tjera mund të mos konsiderohet si i tillë.

Akumulimi i rasteve të ndryshme

45. Për sa i përket vlerësimit, mbikëqyrësi mund të përdorë një trajtim akumulues, që do të thotë se mbikëqyrësi mund të vendosë që individit nuk i plotëson kriteret në bazë të disa rasteve të ndryshme të bëra së bashku, raste të cilat po të merreshin veç e veç nuk do të çonin në të njëjtin përfundim.

Rivlerësimi

46. Një mbikëqyrës mund të vendosë të rivlerësojë kërkesat për përshtatshmëri tek një individ, nëse ai e shikon të arsyeshme të marrë këtë masë.

Ndikimi që ka mënyra e administrimit të biznesit

47. Duhet theksuar që mënyra se si shoqëria e sigurimit administron biznesin e saj, mund të ndikojë në efektshmërinë e personave të caktuar:

o pakujdesia gjatë administrimit të një biznesi, ose kryerja e veprimeve që kanë kërcënuar interesat e personave të siguruar, do të ndikojë negativisht në kompetencat dhe saktësinë në vendimmarrje të personave përgjegjës;

o administrimi i biznesit pa integritet dhe jo profesionalizëm nga shoqëria e sigurimit do të ndikojë negativisht në provën e përshtatshmërisë, kompetencat edhe saktësinë në vendimmarrje të personave përgjegjës.

Ndryshimi i kushteve, politikës dhe strategjisë së biznesit

48. Një rivlerësim mund të jetë i nevojshëm edhe në rastet kur:

o një shoqëri sigurimesh ndryshon politikën apo strategjinë e saj p.sh kur merret me linja të reja biznesi, futet në tregje të reja dhe ndryshon praktikën e investimeve;

o duhet për të verifikuar, nëse njohuritë dhe eksperiencat e individëve janë akoma në nivelin e duhur, në përshtatje me përmasat e biznesit ose me evoluimin e tij.

VII. Masat zbatuese

Kontrollet mbikëqyrëse

49. Një sistem mbikëqyrës sa me efektiv dhe i kuptueshëm, duhet të përfshijë edhe kontrolle të cilat janë përcaktuar që të nxisin përmbushjen e vazhdueshme të provës së përshtatshmërisë apo prova për karakteristika të tjera që kryhen nga mbikëqyrësit.

Masat korrigjuese dhe parandaluese

50. Mbikëqyrësit duhet të kenë në dispozicion të tyre disa masa të një natyre korrigjuese dhe parandaluese, për sa i përket aksionerëve kryesorë dhe funksionarëve kyç që nuk i plotësojnë standartet e përshtatshmërisë apo të karakteristikave të tjera. Këto masa mund të jenë:

o të parandalojnë emërimin nga shoqëria e sigurimit të një individit në pozicionin e një funksionari kyç;

o të pezullojnë apo të shkarkojnë një individ në pozicionin e një funksionari kyç, në mënyre direkte ose duke e urdhëruar shoqërinë e sigurimit ta zbatojë këtë masë;

o të emërojnë një individ në pozicionin e një funksionari kyç në mënyrë direkte ose duke e

urdhëruar shoqërinë ta zbatojë këtë masë për të imponur kështu kontroll dhe administrim sa më të mençur dhe të matur mbi shoqërinë e sigurimit;

o të anullojnë apo të imponojnë kushtet e një licence biznesi, kur ka një shkelje të rëndë të kërkesave për përshtatshmëri, në lidhje me efektin që ka kjo shkelje ose në lidhje me numrin e funksionarëve kyç të përfshirë në këtë shkelje.

Procesi i apelimit

51. Një proces apelimi duhet t'u bëhet i mundshëm individëve të prekur nga vendimet korigjuese që janë vendosur ndaj tyre.

VIII. Dispozita të fundit

52. Bashkëpunimi i lartpërmendur në rang kombëtar, ndërkombëtar apo ndërsektorial me organet policore dhe zyrat financiare, i nënshtrohet rregullave të mbrojtjes të së dhënave dhe të konfidencialitetit, aq sa lejohen nga rregullat dhe traktatet ndërkombëtare.

53. Duhet të theksohet se sipas standarteve mbikëqyrëse mbi shkëmbimin e informacioneve të IAIS, një mbikëqyrës sigurimi duke ju nënshtuar disa masave mbrojtëse, duhet të ketë fuqi e autoritet ligjor dhe të jetë e drejta e tij individuale që të shkëmbejë informacione të caktuara që mblidhen gjatë kryerjes së detyrës së tij, p.sh:

o informacione të vlefshme mbi individët që kanë një pozicion me përgjegjësi në shoqëritë e sigurimit (duke përfshirë këtu aksionerët, drejtorët, administratorët, punonjësit dhe kontraktuesit);

o informacione të vlefshme mbi individët ose shoqëritë e sigurimit që janë përfshirë ose dyshohen të jenë përfshirë në aktivitetet kriminale;

o informacione mbi investigimet dhe rishqyrtimet mbikëqyrëse dhe ndonjë masë ndaluese imponuar shoqërive të sigurimit gjatë aktivitetit të tyre të biznesit.

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, F. Hebovija,
E. Kokona, R. Eltari, O. Zaçaj, E. Sherri

